



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	21.12.2025	02.01.2026	2025/1242

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.12.2025, **OE “AVAG GROUP SH.P.K.”**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1242, kundër njoftimit për dhënie të kontratës per LOT 2 ku është rekomanduar për kontratë **OE “EJONA SH.P.K.”**- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirembajtja teknike e ndertesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI” me nr. të prokurimit: "214-25-4909-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë publike kornizë, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **LOT2: 240,000.00 €**. Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/0850 i dt: 27.10.2025

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Parashtruesi i kësaj Kërkese për Rishqyrtim, operatori ekonomik “AVAG SH.P.K., konsideron se Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Punëve të Brendshme (Komuna e Gjilanit), i shoqëruar me letrat standarde, është kundërshtim me gjendjen faktike, përfshirë kërkesat dhe kriteret e DT, veçanërisht kundërshtim me vendimin përfundimtar të PSH me numër OSHIP:2025/08. Parimet themelore dhe dispozitat përkatëse të procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave. Kështu që, kjo gjendje situatën juridike që procesi dhe vendimi përfundimtar i rivlerësimit nga ana e AK në kundërshtim me një vlerësim të pavarur dhe profesional në kuptim të kriterit të përcaktuara dhe sanksionuara me nenin 59 dhe 60 të LPP. Si rrjedhojë, AK me aktet e saj ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme, duke shkelur dispozitat e mëposhtme:

Dispozita të LPP të listuara si më poshtë:

- Nenin 1 në paragrafin 2 dhe 3 i LPP lidhur me nenin 4.3 i RRPP;
- Nenin 6 në paragrafin 1 lidhur me nenin 4.3 të RRPP;
- Nenin 7 në paragrafin 1, 2, 4 i LPP lidhur me nenin 4.3 të RRPP;

- Nenin 56 në paragrafin 1 i LPP;
- Nenin 59 në paragrafin 4 të LPP
- Nenin 60 në paragrafin 1.1 të LPP;
- Nenin 69 në paragrafin 1 të LPP;
- Nenin 105 në paragrafin 2.10 të LPP
- Nenin 108/A në paragrafin 12 i LPP

Dispozita të RRPP Nr. 02/2024 (Versioni i Konsoliduar) të listuara si më poshtë:

- Nenin 4.3 pika b), e), g) të RRPP;
- Nenin 18 paragrafi 7 të RRPP
- Nenin 27 paragrafi 3
- Nenin 40 në paragrafin 1, 2, 6 dhe 13 të RRPP
- Nenin 62 par. 2 të RRPP
- Nenin 97 paragrafi 1, pika h) të RRPP

Ligji 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: dispozitat si më poshtë:

- Nenin 48 paragrafi 1 i LPPA Nr/ 05/L-031

Rrethanat procedurale të aktivitetit në fjalë.

1. Më datë 05.06.2025, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (në vijim: AK-MPB), ka publikuar në procedurë të hapur dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI”, me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, dhe me vlerë të totale të parashikuar prej 1,320,000.00€ e ndarë në 6 lote.
2. Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim AVAG GROUP SHPK, duke qenë se për aktivitetin përkatës i plotëson aftësitë relevante në raport me kriteret dhe të nevojshme apo minimale financiare, profesionale dhe teknike me personelin dhe pajisjet e nevojshme, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit për realizimin e kësaj kontrate, si palë me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së, ka marrë pjesë në këtë procedurë të prokurimit duke paraqitur ofertën e tij për LOT I me çmim total prej 239,760.00€ dhe LOT II me çmim total prej 239,400.00€.
3. Duke iu referuar procesverbalit të hapjes së tenderit, përveç parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim, në LOT I dhe LOT II të këtij aktiviteti kanë marrë pjesë edhe OE e paraqitur në tabelën si në vijim:

shkeljet e kryera nga AK, ashtu që ka konstatuar gjendjen faktike duke u bazuar në administrimin dhe vlerësimin e të gjitha shkresave e lëndës, pretendimeve ankimore të ankuesit dhe duke ja falur besimin vlerësimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, ka urdhëruar qartë se gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

7. Autoriteti Kontraktues – MPB, pas një zvarritjeje të pajustificuar për më shumë se një muaj në procesin e rivlerësimit për LOT I dhe LOT II, ka vepruar dhe vendosur përsëri mbi të njëjtat fakte dhe rrethana, të cilat tashmë janë konstatuar si të kundërligjshme dhe të papranueshme me vendimin përfundimtar të OSHP-së. Duke mos e respektuar dhe duke vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vendimin e formës së prerë të OSHP-së si dhe me dispozitat ligjore të zbatueshme për çështjen konkrete, më datë 04.09.2025 AK ka marrë një vendim identik me atë paraprak të datës 13.08.2025 me të cilin e ka konfirmuar të njëjtin rezultat (para rivlerësimit) sikur mos të egzistonte fare vendimi i OSHP. Me këtë veprim dhe me këtë akt, AK jo vetëm që nuk ka eliminuar shkeljet e konstatuara nga OSHP, por i ka përsëritur ato, duke e diskualifikuar padrejtësisht ofertën tonë të përgjegjshme me çmimin më të ulët për LOT II dhe duke e shpallur sërish fituese OE "EJONA SHPK", në kundërshtim me gjendjen faktike, juridike dhe me detyrimet e qarta që i janë imponuar nga vendimi i OSHP-së.
8. Për këto arsye, duke qenë se një akt i tillë përbën shkelje të rëndë materiale e procedurale të dispozitave qenësore të LPP-së, moszbatim të parimeve themelore të prokurimit, dhe moszbatim të vendimit të formës së prerë të OSHP-së dhe vazhdimësi të të njëjtave shkelje për të cilat AK është urdhëruar t'i korrigjojë, me pasojë vendosjen në dëm të OE ankues "AVAG GROUP" Shpk, çka na detyron të paraqesim këtë ankesë pranë OSHP përmes së cilës kërkojmë anulimin e vendimit për dhënien e kontratës dhe rivlerësimin e aktivitetit për LOT II në përputhje me LPP-në, dosjen e tenderit dhe gjetjet e vendimit të formës së prerë të OSHP-së nr. 2025/0850.

1. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi i parë

Pretendimi i parë, i paraqitur në disa pika të ndara, ndërlidhet me kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, si dhe me shkeljet e reja që kanë ndodhur gjatë procesit të rivlerësimit dhe që janë bërë të ditura për OE ankues përmes këtij vendimi, i cili nuk mbështetet në gjendjen faktike dhe as në dispozitat përkatëse ligjore.

1. Autoriteti Kontraktues – MPB, me vendimin e publikuar në platformën e e-Prokurimit më 09/12/2025, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga OE "AVAG GROUP" SH.P.K. Megjithatë, duke u nisur nga gjendja faktike e kësaj çështje, e cila është përfundimisht e vërtetuar me vendimin e OSHP-së nr. 2025/0850 të formës së prerë, rezulton se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht Vendimi B58 i AK, tani i atakuar, është i padrejtë, arbitrar dhe në kundërshtim me ligjin.

2. Ky vendim, me të cilin vërtetohet dhe mbetet në fuqi vendimi B58 i atakuar me këtë ankesë nuk mbështetet në vlerësimin e tenderëve në bazë të zbatimit të drejtë të kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese të vendosura në dosjen e tenderit nga vet AK, as në parimet dhe bazën ligjore të LPP-së si ligj material, përfshirë legjislacionin sekondar (RRPP dhe UPP), të cilat rregullojnë kriteret e vlerësimit, parimin e barazisë dhe rregullat për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë dhe dhënien e kontratave. Për më tepër, arsyetimi i dhënë në vendim nuk ka mbështetje në fakte vendimtare dhe as në argumentim të plotë juridik, brenda gjendjes faktike të administruar dhe të vlerësuar tashmë në merita me vendim të formës së prerë nga OSHP, i cili në kuptim të nenit 105 paragrafi 2.16 të LPP konsiderohet çështje e gjykuar "*res juridikata*". Mirëpo, arsyetimi i AK kufizohet në aspekte procedurale, duke iu referuar kthimit të lëndës në rivlerësim dhe duke ngatërruar gjendjen faktike me tentimin për ndryshime materiale në substancën e ofertës së operatorit ekonomik të shpërblyer me kontratë, me qëllim krijimin e përshtypjes se nuk ka pasur shkelje ligjore, ndonëse këto shkelje janë konstatuar përfundimisht nga OSHP.
3. Në vijim parashtrohen faktet dhe arsytet vendimtare nga të cilat rezulton se përmes vendimit të atakuar, është bërë një vlerësim i padrejtë, arbitrar dhe në kundërshtim me kornizën ligjore, LPP dhe RRPP.

E para: AK nuk ka shqyrtuar dhe as arsyetuar vendimin lidhur me pretend. e parë.

- Sa i përket pretendimit të parë, me të cilin është atakuar vendimi i AK për eliminimin e e ofertës tonë në mënyrë të kundërligjshme, ne si parashtrues kemi paraqitur fakte dhe argumente të mjaftueshme që dëshmojnë se oferta jonë i ka përmbushur të gjitha kriteret kualifikuese dhe kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës konform nenit 59.4 dhe nenit 60 par.11 të LPP. Megjithatë, nga arsyetimi i vendimit të atakuar rezulton se AK nuk e ka shqyrtuar fare këtë pretendim, ndonëse ai është thelbësor dhe i mbështetur në prova konkrete.
- Një qasje e tillë e AK sa i përket anashkalimit të shqyrtimit të këtij pretendimi kyç është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 108/ A paragrafi 12 të LPP-së, sipas të cilit kundërshtimet e parashtruara duhet të jenë të trajtuara dhe të arsyetuara, si dhe me nenin 48 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton standardin minimal të arsyetimit të çdo akti administrativ. Sipas këtij neni, një vendim i ligjshëm duhet të përmbajë qartë përshkrimin e kërkesës së palës, gjendjen faktike mbi të cilën mbështetet vendimi, shkaqet vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të zbatuar dhe arsytet për mospranimin e pretendimeve të palës. Mungesa ose paqartësia e këtyre elementeve e barazon vendimin me mungesë arsyetimi.
- Në rastin konkret, arsyetimi i vendimit të kontestuar nuk e përmbush as këtë standard minimal ligjor, pasi nuk sqaron bazën faktike dhe juridike të vendimit, nuk identifikon shkaqet vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe nuk jep asnjë arsye të argumentuar për mospranimin e pretendimit të parë të parashtruesit të

kërkesës për rishqyrtim. Në vend të një vlerësimi thelbësor të këtij pretendimi, AK është njafuar me një përshkrim të shkurtër formal, pa kryer asnjë analizë dhe vlerësim real të fakteve dhe rrethanave konkrete. Por, përmes një përgjigjeje të përgjithshme dhe shabllo, duke parafrazuar dispozita të ndryshme të LPP-së (nenet 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 105), ka deklaruar se ka vepruar në përputhje me ligjin dhe parimin e trajtimit të barabartë, pa paraqitur asnjë provë, fakt apo argument konkret që do ta mbështeste këtë pohim.

- Për këto arsye, rezulton se arsyetimi i dhënë në vendimin e kontestuar të AK nuk përputhet me gjendjen faktike reale, është në kundërshtim me gjetjet e vendimit të formës së prerë të OSHP-së, me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, si dhe me dispozitat e LPP-së që rregullojnë përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, përkatësisht nenet 56, 59 dhe 60 të saj. Nga pikëpamja juridike, kjo sjellje nënkupton se AK është pajtuar në heshtje me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, duke pranuar në thelb se oferta jonë është e përgjegjshme.

E dyta: AK nuk e ka zbatuar vendimin e PSH-së të OSHP-së nr. 2025/0850 në aspektin material lidhur me gjetjet si dhe detyrimet që rrjedhin nga ky vendim.

- Sa i përket pretendimit të dytë, i cili ka për objekt mosrespektimin e vendimit të OSHP-së gjatë procesit të rivlerësimit që ka rezultuar me nxjerrjen e vendimit B58 për dhënien e kontratës, nga arsyetimi i vendimit të atakuar rezulton se **AK vendimin e OSHP e ka trajtuar vetëm në aspekt formal apo procedural, por jo në aspektin material.** Konkretisht, AK – MPB, konsideron se ka zbatuar vendimin e OSHP për faktin se lënda është kthyer në rivlerësim dhe është formuar një komision për rivlerësimin e ofertave, që sipas AK e ka bërë sipas kriterëve të DT.
- Megjithatë, një arsyetim i tillë nuk adreson thelbin e pretendimit, pasi respektimi i vendimit të OSHP-së nuk konsiston vetëm në ndërmarrjen e veprimeve formale, por në zbatimin material dhe të plotë të gjetjeve dhe udhëzimeve të përmbajtura në atë vendim.
- Nga vendimi i OSHP me numër 2015/0850 i cili është i formës së prerë, rezulton se Paneli Shqyrtues, ka konstatuar shkelje thelbësore në vlerësimin e ofertave nga AK, duke i dhënë besim të plotë raportit të ekspertit shqyrtues, duke anuluar njoftimin për dhënie të kontratës dhe duke e kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, me detyrim që AK të veprojë në përputhje të plotë me gjetjet thelbësore të ekspertit shqyrtues dhe duke u mbështetur në kriteret e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së. Rivlerësimi është kërkuar pikërisht për shkak se vlerësimi i ofertave nga ana e AK nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe kriteret ligjore të LPP dhe RRPP.

- Ju lutem shihni në vijim vlerësimin dhe gjetjet e ESH-së lidhur me ofertën e OE të shpërblyer me kontratë, të cilave PSH-ja u ka dhënë besim të plotë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me kërkesat teknike dhe profesionale të cilat sipas kërkesave të FDT-se **Për Lot- II Kërkesa: 6)- Një (1) Teknike (ventilim – klimatizim-ngrohje)**

Dëshmia: 6) Për teknikun Diploma ose Certifikata -profesionale përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e AK-se në këtë pikë ka qenë specifike duke kërkuar Teknik, (ventilim – klimatizim-ngrohje) ndërsa me ofertë është dorëzuar drejtimi Makineri me profilin Metalpunues e cila nuk ka të bëjë fare me drejtimin që është kërkuar prandaj AK- gjatë vlerësimit të ofertave në këtë pikë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-se, nenin 4.3 paragrafi c dhe nenin 40.6 paragrafi c, si dhe 40.7 të RRPP 002/2024.

AK, në këtë mënyrë, ka përdorur standarde të dyfishta gjatë vlerësimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe se **pretendimi është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale të cilat sipas kërkesave të FDT-se është kërkuar:

2. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojë se ka kontratë të përfunduara në lëmin e kërkuar-mirëmbajtje teknike ose të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhë e shkuar trivjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo më pakë së për:

LOT -II - 200,000.00 €;

2. Lista e kontratave të përfunduara e nënshkruar dhe vëlosur nga OE për projekte të realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar.

Kur janë realizuar për autoritetin publik, si dëshmi për këtë realizim do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencës përkatëse të lëshuar nga autoriteti i tillë publik.

Ndërsa për kontratë të cekura në listë; që janë realizuar për blerësin privat, dëshmi për këtë realizim duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë, (si dëshmi duhet të ketë dëshmi nga banka), duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë, me ofertë, ka dorëzuar një listë prej 51 projekteve. Eksperti shqyrtues sqaron se lista e kontratave nuk përputhet me referencat e dorëzuara dhe si rrjedhojë nuk mund të vlerësohet vlera e projekteve të realizuara sipas listës. Për më tepër lista e projekteve ka të përfshirë projekte të cilat nuk hyjnë në periudhën e shkuar trivjeçare të kërkuar me FDT.

Pas administrimit të provave (listës dhe referencave), eksperti shqyrtues vlerëson se projektet e përfshira në listë, duhet të identifikoheshin dhe të vlerësoheshin nga AK në bazë të FPP-së dhe kërkesave të FDT-se. rrjedhimisht, AK gjatë vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40.2, 40.6 dhe 40.7 të RRPP 002/2024 dhe se **pretendimi ankimor është i bazuar.**

- Këto gjetje të ekspertit shqyrtues, të cilave PSH, në konstatimet e vendimit të tij, u ka dhënë besim të plotë, përbëjnë udhëzime detyruese për zbatim material dhe jo vetëm procedural, vërtetojnë në mënyrë të qartë se tenderi i paraqitur nga OE “EJONA” SH.P.K. është i papërgjegjshëm, për faktin se është konstatuar se nuk

i ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas DT-së, ashtu siç parashihet me nenin 57, paragrafi 4 të LPP-së. Në bazë të kësaj gjendjeje faktike dhe juridike, tenderi i OE në fjalë është dashur të refuzohet si i papërgjegjshëm, sepse nuk ka plotësuar kushtet për të kaluar në fazën e vlerësimit, siç parashihet me nenin 60 par.1.1 të LPP-së. Në këtë kuptim, një tender i tillë konsiderohet palë pa interes juridik material në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

- Megjithatë, veprimet e ndërmarra nga AK, si dhe rezultati i procesit të rivlerësimit, i cili ka përfunduar me të njëjtin vendim të dëshiruar nga AK për dhënien e kontratës me çdo kusht operatorit ekonomik "EJONA" SH.P.K., të favorizuar nga AK, për të cilin Paneli Shqyrtues kishte konstatuar me vendim meritore se ka paraqitur tender të papërgjegjshëm, nuk pasqyrojnë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara që kishin çuar në anulimin e vendimit fillestar të AK-së të datës 13.08.2025. Kjo situatë dëshmon se procesi i rivlerësimit është trajtuar si një formalitet procedural, duke iu referuar në mënyrë të pasaktë dispozitës së nenit 116, paragrafi 6 të LPP-së, e cila në rrethanat e rastit konkret nuk gjen zbatim, dhe jo si një vlerësim real dhe substancial, në përputhje me kërkesat dhe kriterin e dhënies së kontratës sipas DT-së, si dhe me dispozitat qenësore të LPP-së (nenet 1, 6, 7, 59 dhe 60). Njëkohësisht, ky veprim dhe vendim i AK është në kundërshtim të plotë me gjetjet dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi i OSHP-së, me të cilin AK është pajtuar në heshtje, duke mos ushtruar të drejtën e ankimimit pranë gjykatës kompetente.
- Prandaj, mbi analizën e kësaj gjendje faktike dhe juridike, rezulton se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, pasi duke u ndikuar nga interesat dhe dëshirat personale apo tjera me qëllim të krijimit të favoreve për OE ekonomik "EJONA" SH.P.K., në dëm të OE ankues në mënyrë arbitrare dhe të paligjshme ka përdorur rivlerësimin si mjet formal për të justifikuar një rezultat të paracaktuar dhe siç po shihet qartë të dëshiruar për AK për dhënien e kontratës operatorit ekonomik "EJONA" SH.P.K., i vlerësuar si i papërgjegjshëm me vendim të formës së prerë nga OSHP.
- Kjo situatë, vërteton qartazi se procesi i rivlerësimit nuk ka sjellë korrigjim real të shkeljeve të konstatuara, por ka prodhuar një vendim të paracaktuar që bie ndesh me parimet e prokurimit publik dhe me efektin detyrues të vendimeve të OSHP-së. Ky veprim e bën rezultatin e procedurës të paqëndrueshëm juridikisht, cenon barazinë e operatorëve ekonomikë dhe krijon pasiguri në zbatimin e ligjit.
- Në këto rrethana, procesi i rivlerësimit nuk ka pasur karakter real, por është trajtuar si formalitet procedural me qëllim justifikimin e një rezultati të paracaktuar, duke mos zbatuar detyrimet materiale që rrjedhin nga vendimi i OSHP-së. Për më tepër, rezulton se AK ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencën dhe sigurinë juridike, duke krijuar një precedent të rrezikshëm ku

vendimet e organit administrativ të shkallës së dytë (OSHP) përkitazi me çështjet e gjykata "*res juridicata*" nuk zbatohen materialisht, por anashkalohen përmes formaliteteve procedurale, me qëllim favorizimin e një operatori ekonomik të papërgjegjshëm në kundërshtim me ligjin. Për më tepër, nga analizimi logjik dhe juridik, rezulton se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik: barazinë e operatorëve ekonomikë, transparencën dhe sigurinë juridike, duke krijuar precedent të rrezikshëm ku vendimet e organeve të shkallës së dytë (OSHP) nuk zbatohen materialisht, por anashkalohen me formalitete, për të favorizuar një OE të papërgjegjshëm në kundërshtim me ligjin.

- Për këto arsye, vendimi i ri është i paligjshëm, pasi përbën shkelje të drejtpërdrejtë të dispozitave materiale të LPP-së dhe RRPP-së, duke vendosur në dëm të operatorit ekonomik ankues dhe duke i cenuar atij të drejtën për t'u shpërblyer me kontratë, ndonëse i njëjti përmbush kriteret kualifikuese dhe kriterin vlerësues për shpërblyer me kontratë për Lotin II.

E treta: Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 72 të LPP-së duke kërkuar sqarime nga OE EJONA SH.P.K., ndonëse me vendim të formës së prerë të OSHP-së, me të cilin AK është pajtuar, kjo ofertë është konstatuar si tender i papërgjegjshëm.

- Bazuar në arsyetimin e vendimit të atakuar të AK (pasuesi 3, fq. 11), rezulton qartë se dispozita e nenit 72 të LPP-së është përdorur në mënyrë të kundërligjshme për të justifikuar një rezultat të paracaktuar nga ana e AK-së, përkatësisht dhënien e kontratës operatorit ekonomik "EJONA" SH.P.K., i cili është vlerësuar si tender i papërgjegjshëm me vendim të formës së prerë të OSHP-së.
- Nga kërkesa për sqarime e dërguar nga AK drejtuar OE "EJONA" SH.P.K. vërehet se vetë kjo kërkesë është kontradiktore në përmbajtje, çka tregon se ajo është iniciuar me qëllim të justifikimit dhe rikonfirmimit të vendimit paraprak për shpërblyerjen e këtij operatori ekonomik, pavarësisht konstatimit se oferta e tij është e papërgjegjshme. Nga njëra anë, AK konstaton dhe i bën të ditur OE EJONA SH.P.K. se nuk ka përmbushur kërkesën lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale, konkretisht kërkesën nr. 6 për stafin profesional, duke evidentuar mospërputhje për stafin me numër rendor 3 dhe 7, të cilat më pas i relativizon duke i cilësuar si "*gabim teknik*". Nga ana tjetër, pavarësisht këtij konstatimi që e kualifikon ofertën si të papërgjegjshme, AK ndërmerr me vetëdije veprimin e kërimit të sqarimeve nga i njëjti tenderues i papërgjegjshëm, në kundërshtim me qëllimin dhe kufijtë e nenit 72 lidhur me nenin 59.4 të LPP-së. Kështu, nga arsyetimi i vendimit të atakuar të AK-së (pasuesi 3, fq. 11), rezulton se është përshkruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa asnjë vlerësim përmbajtja e deklaratës së pranuar nga OE EJONA SH.P.K., duke e trajtuar atë si të mjaftueshme për justifikimin e vendimit të dëshiruar.

- Kjo sjellje e tillë e AK që tejkalon qëllimin dhe kufijtë ligjor të LPP-së, dëshmon "përdorimin e sqarimeve" për justifikimin, rehabilitimin dhe favorizimin e një oferte të papërgjegjshme dhe rikonfirmimin e një rezultati të paracaktuar, në dëm të OE ankues në mënyrë që t'i cenohet e drejta ligjore për t'u shpërblyer me kontratë, ndonëse i njëjti përmbush kriteret kualifikuese dhe kriterin vlerësues për shpërblyer me kontratë për Lotin II.
- Megjithatë, vlerësimet dhe gjetjet e ekspertit shqyrtues, të mbështetura në fakte dhe argumente të mjaftueshme lidhur me gjendjen reale të dosjes së OE EJONA SH.P.K., të cilave Paneli Shqyrtues u ka dhënë besim të plotë në konstatimet e vendimit të tij, vërtetojnë qartë se tenderi i paraqitur nga ky operator ekonomik nuk e ka përmbushur kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht kërkesën nr. 6 për një teknik të fushës klimatizim-ventilim-ngrohje, ashtu siç është përcaktuar në dosjen e tenderit dhe në përputhje me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së.
- Madje, edhe nëse hipotetizohet do të merrej në konsideratë ekzistenca e një situate të tillë, konstatimet dhe arsyetimet e dhëna në aktet e AK nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për klasifikimin e ofertës së OE EJONA SH.P.K. si ofertë të përgjegjshme. Një vlerësim i tillë bie ndesh me gjendjen faktike dhe ligjore ekzistuese, duke pasur parasysh se OSHP-ja ka konstatuar se ky operator ekonomik nuk e ka përmbushur as kërkesën nr. 2, lidhur me dëshmitë për kontrata të përfunduara në fushën e kërkuar të mirëmbajtjes teknike ose të ngjashme, sipas Njoftimit për Kontratë, për periudhën e fundit trevjeçare, në vlerën minimale të kërkuar për Lotin II prej 200,000.00 €.
- Përfundimisht, rezulton se procesi i rivlerësimit nuk është kryer në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga vet AK në dosjen e tenderit, as me nenin 59 paragrafi 4 dhe nenin 60 paragrafi 1.1 të LPP-së, si dhe në kundërshtim me gjetjet dhe udhëzimet detyruese në aspektin material të vendimit të OSHP-së, i cili ka konstatuar qartë se tenderi i paraqitur nga OE "EJONA" SH.P.K. është i papërgjegjshëm për shkak të mosplotësimit të kërkesave të dosjes së tenderit.

Në vijim paraqiten pretendimet ankimore të dorëzuara pranë autoritetit kontraktues në kuadër të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 18/08/2025

Pretendimi i dytë (i paraqitur si pretendimi i parë në Kërkesës për Rishqyrtim)

1. Parashtruesi i kërkesës vlerëson se vendimi i AK-së për të eliminuar ofertën tonë të përgjegjshme me çmimin më të ulët për LOT II dhe për të rishpallur fituese OE "EJONA SHPK", mbi të njëjtat fakte dhe rrethana që tashmë janë konstatuar si të kundërligjshme me vendimin përfundimtar të OSHP-së, dëshmon se ZPP i AK-së ka vepruar me vetëdije në kundërshtim të qartë me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit nga vetë AK-ja, si dhe në shkelje flagrante të dispozitave ligjore përkatëse sipas neneve 1, 6, 7, 56, 59, 60 dhe 105 të LPP-së, të cilat rregullojnë kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve dhe dhënien e kontratave. Dhënia e kontratës një OE-je pa bazë ligjore, në

kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me vendimin e formës së prerë të OSHP-së, bie ndesh me dispozitat e nenit 56 par. 1.1, në lidhje me nenin 59 par. 4 dhe nenin 60 par. 1.1 të LPP-së, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar kriteret e përgjegjshmërisë dhe kriterin për dhënien e kontratës. Njëkohësisht, një vendimarrje e tillë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet themelore të prokurimit publik, konkretisht shkelje të nenit 1 në lidhje me nenin 7 të LPP-së, të cilat sanksionojnë parimin e trajtimit të barabartë dhe ndalimin e diskriminimit, duke kërkuar që vendimet e AK-së të jenë të paanshme, jo-diskriminuese, transparente dhe plotësisht në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore të ligjit.

Si pasojë e kësaj vendimarrje të kundërligjshme, është krijuar një situatë juridike në dëm të OE ankues, pasi është eliminuar padrejtësisht oferta jonë e përgjegjshme për LOT II, ndonëse i ka përmbushur plotësisht të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies të përcaktuara në dosjen e tenderit. Kështu që, në kundërshtim me këtë gjendje dhe duke u bazuar në konsiderata tjera përtej atyre ligjore, AK ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik që nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit (kriteret e përgjegjshmërisë), të cilat përbëjnë kushte thelbësore dhe të detyrueshme; mospërmbushja e tyre e bën ofertën të papërgjegjshme pavarësisht çmimit të ofruar.

Në vijim të kësaj situatë, në këtë pjesë paraqesim në mënyrë të detajuar faktet dhe provat konkrete për të argumentuar çdo veprim dhe akt të kundërligjshëm të AK-së, i cili ka rezultuar me diskualifikimin e padrejtë të ofertës sonë i cili mbështetet në një arsyetim të pabazuar në kontekstin e gjendjes faktike dhe bazës ligjore.

2. Në arsyetimin e Letrës Standarde të datës 04.09.2025 për eliminimin e ofertës së OE “AVAG GROUP” Shpk për LOT II, AK ka përdorur të njëjtin arsyetim si në Letrën Standarde të datës 13.08.2025 (para rivlerësimit), sikur vendimi i OSHP-së nr. 2025/0850 të mos ekzistonte fare. Si bazë për shpalljen e ofertës sonë si të papërgjegjshme, AK ka pretenduar se kinse nuk kemi përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional duke u mbështetur në pretendimin se lista jonë nuk i mbulon kriteret për të dy lotet, si dhe ka përdorur si pretekst arsyetimin se vendimi për caktimin e menaxherit nuk e përmbush kërkesën e DT-së, meqenëse sipas tyre nuk është specifikuar për cilin LOT është propozuar. Ju lutem në detaje për secilin arsyetim referoju Letrës Standarde të AK
3. Duke u mbështetur në rrethanat e plota të gjendjes faktike në të gjitha fazat e procesit, veçanërisht në gjetjet dhe konstatimet e evidentuara në vendimin e PSH-së të OSHP-së nr. 2025/0850, si dhe në konstatimet e ekspertit shqyrtues që janë pranuar plotësisht nga PSH-ja, bëhet e qartë se ky arsyetim është tërësisht i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në kontekstin faktik dhe ligjor. Arsyetimi i përdorur nga AK për të justifikuar eliminimin e ofertës sonë është i pavlefshëm në themel, sepse bie ndesh me vendimin e formës së prerë të OSHP dhe me dispozitat thelbësore të LPP-së dhe RRPP-së që rregullojnë përgjegjshmërinë dhe dhënien e kontratës. Në realitet, kjo vendimarrje nuk është rezultat i zbatimit të ligjit dhe vendimit të formës së prerë të OSHP, por i konsideratave tjera, të përdorura për të krijuar një arsyetim artificial që i hap rrugë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**AVAG GROUP SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI**” me numër të prokurimit: “**214-25-4909-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

--

tepër, duke marrë parasysh kontekstin krahasues të rregullave të përgjithshme të prokurimit s ai përket përmbushjes së kriterëve minimale në situatën kur OE konkurren në më shumë se një lot, duhet të përmbushë kërkesat minimale për të gjithë lotet së bashku, rezulton se dokumentacioni që kemi dorëzuar, veçanërisht dëshmitë për teknikët e ndërtimtarisë të kërkuar vetëm për LOT II, tregon qartë se oferta jonë është dedikuar për LOT II, gjë që e rrëzon pretendimin e AK-së

8. Për më tepër, në arsyetimin e letrës standarde të AK për eliminimin e ofertës tonë, përveç konstatimeve që nuk qëndrojnë në kontekstin faktik dhe ligjor, janë përdorur vlerësime kontradiktore dhe me standarde të dyfishta në mënyrë që të justifikohet vendimi i AK-së i cili është orientuar drejt një rezultati të parapërcaktuar dhe të kundërligjshëm drejt OE EJONA SHPK. Ky përdorim i standardeve të dyfishta dhe kontradiktore që nuk përputhet me kriteret ligjore të qëllimit të këtij ligji, është vërtetuar edhe në gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues. Mbi këtë gjendje faktike dhe duke ju referuar edhe arsyetimit të AK në vendimin të datës 26.08.2025 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues AVAG GROUP, AK vet e ka konstatuar s OE EJONA nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes për LOT II, përkundrazi e rekomandon për dhënie të kontratës duke u justifikuar se ka staf të mjaftueshëm që mund të merret nga stafi i prezentuar për lote tjera.
9. Si përfundim lidhur me këtë pretendim, nga të gjitha faktet dhe rrethanat e paraqitura më sipër dhe mbi bazën e parimeve themelore të prokurimit publik, rezulton se vendimi përfundimtar i rivlerësimit është marrë në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së, me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vendimin e formës së prerë të OSHP-së, i cili ka qenë detyrues për AK.

Ju lutem shihni në vijim vlerësimin dhe gjetjet e ESH-së lidhur me ofertën e OE ankues të cilave PSH-ja u ka dhënë besim të plotë.

Pretendimi i tretë (i paraqitur si pretendimi i dytë në Kërkesës për Rishqyrtim)

10. Me vendimin e OSHP: 2025/0850, Paneli Shqyrtues i OSHP, e ka anuluar vendimin për dhënie të kontratës për Lot I dhe Lot II dhe ka urdhëruar AK-MPB kthimin e lëndës në rivlerësim. Në arsyetimin meritore të vendimit, Paneli Shqyrtues ka vërtetuar shkeljet e kryera nga AK, ashtu që ka konstatuar gjendjen faktike duke u bazuar në administrimin dhe vlerësimin e të gjitha shkresave e lëndës, pretendimeve ankimore të ankuesit dhe duke ja falur besimin vlerësimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, ka urdhëruar qartë se gjatë rivlerësimit AK të veprojnë në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.
11. Paneli Shqyrtues, duke u bazuar në administrimin dhe vlerësimin e të gjitha shkresave e lëndës, pretendimeve ankimore të ankuesit dhe duke ja falur besimin vlerësimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, ka konstatuar se vlerësimi i aktivitetit në raport me objektin ankimor për LOT II është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Konkretisht duke ju referuar gjetjeve dhe konstatimeve të ekspertit shqyrtues të cilat janë mbështetur në tërësi nga PSH në raport me ofertën/tenderin OE EJONA SHPK sa i përket LOT II, eksperti qartësisht ka konstatuar se tenderi i dorëzuar nga OE në fjalë konsiderohet i papërgjegjshëm për shkak

- Nuk i përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit sa i përket kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht kërkesës 6 – Një teknik (ventilim – klimatizim – ngrohje), si dhe kërkesës me numër 2 sa i përket listës së kontratave të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar.

12. Pavarësisht se AK duhet të jetë i vetëdijshëm se vendimet e OSHP janë përfundimtare dhe tyë detyrueshme për AK dhe palët në procedurë, vendimi i atakuar e vërteton se AK me qëllim nuk e ka respektuar në aspektin material të gjetjeve dhe detyrimeve vendimin nr. 2025/0850, por rivlerësimin, respektivisht vendimin b58 e ka marrë në kundërshtim me gjetjet e ekspertit shqyrtues në aspektin material të cilave PSH ju ka dhënë besim të plotë dhe detyrimet që rrjedhin nga ky vendim i firmës se prerë i cili është detyrues për AK dhe të gjitha palët në procedurë. Mirëpo, duke u bazuar në konsiderata tjera që bien ndesh veçmas me nenin 1 lidhur me nenin 24 të LPP, vendimarrjen e ka mbështetur duke e përsëritur të njejtin arsyetim të justifikuar në fakte për rrethanat e njejta të cilat OSHP i ka rrëzuar si veprime dhe akte të kundërligjshme. Në këtë mënyrë AK ka shkelur parimet themelore të prokurimit publik: ligjshmërtisë, barazisë, konkurrencës dhe transparencës, të cilat janë pjesë qenësore e dispozitave kryesore të LPP dhe RRPP.

13. Ne konsiderojmë se moszbatimi i qëllimshëm i vendimit të OSHP-së në aspektin material ka për qëllim të vazhdojë dëmtimin e pozitës sonë si operatorë ekonomikë të përgjegjshëm dhe të kualifikuar për t'u shpërblyer me kontratë për Lot 2. Për më tepër kjo sjellje e AK-së përbën shkelje të rëndë sikurse parashihet në nenin 97 paragrafi 1, pika h) të RRPP, dhe përbën bazë për shqiptimin e gjobës ndaj AK-së si dhe për revokimin e certifikatës profesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit në këtë institucion.

Ju lutem shihmi në vijim vlerësimin dhe gjetjet e ESH-së lidhur me ofertën e OE të shpërblyer me kontrate, të cilave PSH-ja u ka dhënë besim të plotë.

3. Përfundim me propozime

Andaj duke marrë parasysh të gjitha arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lart, OE ankues EL-BAU SH/P/K/ i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, administrimit të shkresave të lëndës dhe provave në shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenin 104, 105 dhe 107 dhe 117 të LPP-së, të merr këtë:

V E N D I M

- **MIRATOHET E BAZUAR** në tërësi Ankesa e parashtruar nga AVAG GROUP;

- **ANULOHE**T Njoftim Vendimi i AK - MPB i dt. 27/11/2025, në pjesën për LOT II
- **DETYROHE**T AK - MPB që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe rivlerësimin ta bëjë sipas rrethanave faktike në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit, kërkesat ligjore të LPP-së dhe RRPP si dhe gjetjeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i OSHP, ashtu që të rikonstatojë tenderin e paraqitur nga OE EJONA SHPK si tender të papërgjegjshëm dhe të vazhdojë me shpërbllim të kontratës OE në radhë AVAG GROUP si tenderues i përgjegjshëm me çmim më të ulët për LOT II
- **INICOHE**T procedura për shqiptimin e gjobës administrative ndaj AK-së, si dhe procedimin para ZPP-së për revokimin e certifikatës së prokurimit publik.
- **DETYROHE**T AK - MPB që ankuesit t’ia bëjë kompensimin e shpenzimeve procedurale të cilat do të përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet rrjedhëse për të përgatitur ankesën dhe për përgjigjet e kërkesave të ekspertit shqyrtues apo panelit shqyrtues (aq sa do të përcaktohen nga paneli shqyrtues i OSHP-së)

KRITERET PËR VLERËSIM

		<u>Për Lot- II</u>	<u>Për Lot- II</u>
		a) Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të paraqes stafin teknik profesional për ekipin menaxhuës Lista e stafit për Llot II. 1) - Një (1) menaxher të kontratës i cili duhet të jetë nga fusha e Inxhinierisë minimum Bachelor ; 2) - Një (1) Teknike të Elektrikes 3) - Një (1) Teknike të Makinerisë 4) - Një (1) Teknike të Ndërtimtarisë 5) - Një (1) Teknik - (Instalues i ujit dhe kanalizimit) 6)- Një (1) Teknike (ventilim –	a) . Lista e stafit e vulosur dhe nënshkruar nga OE; 1) Për menaxherin e kontratës Vendimi i nënshkruar dhe vulosur nga OE, Diploma përkatëse kopje e notorizuar nga origjinali, CV- , kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. 2) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. 3) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. 4) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2		

		klimatizim-ngrohje) b) Kujdestaria 1) - Një (1) Teknike të (Elektros). 2) - Një (1) Teknike (Instalues i ujit)	valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. 5) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. 6) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. b) Kujdestaria 1) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje. 2) Për teknikun Diploma ose Certifikata - profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje.
		2. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmoj së ka kontrata të përfunduara në lëmin e kërkuar-mirëmbajtje teknike ose të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pakë së për: LOT -I - 250,000.00 €; LOT -II - 200,000.00 €; LOT -III - 200,000.00 €; LOT -IV - 200,000.00 €; LOT -V – 150,000.00 €; LOT -VI - 150,000.00 €; Në rast së operatori ekonomik dorëzon tender për 2 (Dy) apo me shumë Lote, atëherë shuma totale e projekteve të përfunduara duhet ta tejkaloj	2. Lista e kontratave të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar. Kur janë realizuar për autoritetin publik, si dëshmi për këtë realizim do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencës përkatëse të lëshuar nga autoriteti i tillë publik. Ndërsa për kontrata e cekura në listë; që janë realizuar për blerësin privat, dëshmi për këtë realizim duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë, (si dëshmi duhet të ketë dëshmi nga banka). duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.

		shumën e qarkullimit të Lotit me vlerë më të madhe dhe në rast së Operatori Ekonomik dorëzon tender për një pjesë (Lot), atëherë duhet të përmbush qarkullimin e atij Loti.	
--	--	---	--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

Komisioni i ri-vlerësimit, pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatorit Ekonomik, konstatoi këto mospërputhje me kërkesat e dosjes së tenderit:

1. Ne dosjen e tenderit është kërkuar qe OE të caktojë e një menaxheri të dedikuar për secilin llot e qe nuk është respektuar-OE ka dorëzuar vetëm një menaxher pa specifikuar se për cilin llot është propozuar, duke mos përmbushur kërkesën minimale të detyrueshme.
2. Gjithashtu është kërkuar q OE te paraqes një listë të stafit të angazhuar për secilin llot e cila nuk është përmbushur. OE ka ofruar vetëm një listë të përgjithshme të stafit pa ndarje sipas lotëve, çka e bën të pamundur vlerësimin e përmbushjes së kërkesave teknike për secilin llot.

Bazuar në sa më sipër, komisioni vlerëson se oferta e Operatorit Ekonomik **nuk i përmbush kërkesat esenciale** të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe, për këtë arsye, shpallet **I pa përgjegjshëm dhe eliminohet nga procedura e mëtejme e vlerësimit.**

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm"

Radhë	Lënda / grupi: Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Llot - I	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	LURN SH.P.K., 810084062	149,040.00

Radhë	Lënda / grupi: Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Llot - II	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	" EJONA " SH.P.K., 810089913	214,444.80

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i ri-vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave, për tenderin me Titull: Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I dhe II., pas shqyrtimit të tërësishëm të dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesi në tenderin e tij, duke u bazuar në kriterin për dhënien të kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët), si dhe ka respektuar vendimin e PSH të OSHP: nr. 2025/0850 për këto Lote:

Për Llot – I janë pranuar gjithsejte pes (5) oferta dhe për Llot – II janë pranuar gjithsejte dy (dy) oferta pas analizimit të dokumentacionit ofertat e përgjegjshme sipas Lotëve me çmimin me të ulët janë si poshtë dhe i rekomandojnë zyrtarit përgjegjës të prokurimit, që me këtë kontratë të shpërblehet tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët të tenderuesit për secilin Llot:

Për Llot – I Operatori Ekonomik ' LURN SH.P.K., Rr Ibrahim Krasniqi nr.10, 10000, Prishtine në vlerë totale të ofertës, prej 149,040.00€
Për Llot – II Operatori Ekonomik " EJONA " SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja në vlerë totale të ofertës, prej 214,444.80 €

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/0850 i dt: 27.10.2025

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - AVAG GROUP SH.P.K.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me vendimin e AK-së në procesin e rivlerësimit, të cilin AK e ka zhvilluar në bazë të Vendimit të PSH 2025/850, si dhe me përzgjedhjen e OE të rekomanduar për kontratë. Pretendimet janë të përmbledhura kryesisht në mënyrën e vlerësimit të ofertës dhe trajtimit të ofertave, të cilat, sipas OE ankues, janë trajtuar në kundërshtim me nenet 1, 6, 7, 56, 59, 60 dhe 105 të LPP-së.

I gjithë pretendimi mbështetet në arsyetimin e AK-së për eliminimin e OE ankues nga procedura e tenderimit, si dhe në mënyrën se si është rekomanduar OE *Ejona Shpk* për shpërblim me kontratë.

Duke pasur parasysh ankesën 2025/850, trajtimin e pretendimeve të cilat janë të njëjta me pretendimet e paraqitura në këtë ankesë dhe të cilat janë shtjelluar nga OE ankues, eksperti shqyrtues do t'i trajtojë ato si një pretendim të vetëm.

Eksperti shqyrtues sqaron në mënyrë kronologjike hapat e ndërmarrë për këtë procedurë ankimore.

Me datën 27.10.2025 është marrë vendimi i PSH-së me nr. 2025/0850, si më poshtë:

Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Avag Group SH.P.K., me nr. 2025/0850, e dates 04.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - II me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin për LOT II dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

AK, sipas vendimit të PSH-së, ka kthyer aktivitetin e prokurimit për LOT II në rivlerësim dhe, me datën 26.11.2025, ka ngarkuar raportin e rivlerësimit të komisionit me të gjeturat si më poshtë:

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe/ose profesionale:

Komisioni i ri-vlerësimit, pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, konstatoi këto mospërputhje me kërkesat e dosjes së tenderit:

1. Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të caktojë një menaxher të dedikuar për secilin LOT, kërkesë e cila nuk është respektuar – OE ka dorëzuar vetëm një menaxher pa specifikuar se për cilin LOT është propozuar, duke mos përmbushur kërkesën minimale të detyrueshme.
2. Gjithashtu është kërkuar që OE të paraqesë një listë të stafit të angazhuar për secilin LOT, kërkesë e cila nuk është përmbushur. OE ka ofruar vetëm një listë të përgjithshme të stafit, pa ndarje sipas lotëve, çka e bën të pamundur vlerësimin e përmbushjes së kërkesave teknike për secilin LOT.

Bazuar në sa më sipër, komisioni vlerëson se oferta e Operatorit Ekonomik nuk i përmbush kërkesat esenciale të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe, për këtë arsye, shpallet i papërgjegjshëm dhe eliminohet nga procedura e mëtejme e vlerësimit.

OE ankues ka ankimuar vendimin e AK-së për rekomandim të OE Ejona Shpk përmes kërkesës për rishqyrtim, të cilën AK e ka hedhur si të pabazuar me arsyetimin:

Bazuar në nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik janë kërkuar sqarime nga OE tashme i përzgjedhur fitues dhe mbi bazën e sqarimeve të ofruar nga OE, komisioni i rivlerësimit me të drejtë ka vendosur për të shpërblyer me kontratë OE të njëjtës si në vendimin fillestar.

Rrethanat e çështje, OE i rekomanduar në këtë aktivitet të prokurimit të ndare në 6 Lote kishte aplikuar në 3 LLOTE dhe i njëjti ka dorëzuar dhe propozuar listat e stafit dhe menaxheret për secilin Llot veç e veç ashtu siç ishte kërkuar me dosjen e tenderit. Në listën e stafit për Llotin 2 të propozuar nga OE i rekomanduar për kontratë shihen se janë paraqitur 8 persona përfshirë edhe menaxherin e kontratës.

Komisioni i rivlerësimit të ofertave pas kontrollimit të ofertës ka vrejtur se për llotin 2 stafi i propozuar sipas dokumenteve dhe certifikimeve dhe kualifikimeve të dorëzuar i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit por që lista e dorëzuar ka një mos përputhje. Në lidhje me këtë komisioni i rivlerësimit bazuar në nenin 72 të LPP ka kërkuar sqarim për stafin dhe përgjigjejen e kemi marrë si më poshtë:

“:Në dokumentacionin e dorëzuar para hapjes së tenderit kemi kompletuar dosjen me të gjitha dokumentet e kërkuara në DT.

Sa i përket teknikeve ju njoftojmë se janë dorëzuar:

- Një (1) menaxher të kontratës i cili duhet të jetë nga fusha e Inxhinierisë minimum Bachelor ; (ANTIMON BLAKA)

- Një (1) Teknike të Elektrikes (SADRI KASTRATI)

- Një (1) Teknike të Makinerisë (ALTIN LAJQI)

- Një (1) Teknike të Ndërtimtarisë (BEKIM GASHI)

- Një (1) Teknik - (Instalues i ujit dhe kanalizimit) (ISUF RAMA)

- Një (1) Teknike (ventilim – klimatizim-ngrohje) (MENTOR PRELVUKA)

b) Kujdestaria :

- Një (1) Teknike të (Elektros). (LABINOT LUTA)

- Një (1) Teknike (Instalues i ujit) (BEDRI GASHI)

Ndërsa, në listen e dorëzuar ka qenë permutacion i renditjes së numrit 3 dhe 6.

Pra, sipas dokumentave në kemi plotësuar të gjitha kërkesat e DT, të deshmuar me diploma dhe dokumentet tjera përcjellese.”

Komisioni i rivlerësimit si dhe ZPP ka shqyrtuar sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë dhe ka konstatuar se në listën e dhënë ka vetëm një gabim teknik të numrit 3 dhe 6 sepse stafi i prezantuar për Llotin 2 i plotëson kërkesat me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Bazuar në të dhënat e dokumenteve të tenderit dhe sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar

ZPP konsideron se ky pretendim është i pa bazuar.

Ekspteri shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve dhe administrimit të provave të ngarkuara në e-Prokurim, si dhe provave shpesh të marra përmes kërkesave për sqarim nga AK, përgjigjes së AK-së në raportin e ekspertizës 2025/850, vendimit në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues, sqaron se komisioni i vlerësimit i caktuar nga AK ka rivlerësuar ofertat për LOT II dhe, për pretendimin e parë lidhur me stafin, ka kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar, për të cilin OE ka dhënë sqarim se gjatë përgatitjes së ofertës ka ndodhur një permutacion, të cilin sqarim AK e ka pranuar dhe vlerësuar se është në pajtim me kërkesat e FDT-së.

Sa i përket pjesës së pretendimit të dytë, i cili është përsëritur edhe në këtë procedurë ankimore, ekspertit shqyrtues sqaron se, përkundër rekomandimit të ekspertizës që e trajton këtë pretendim, janë konstatuar këto vërejtje: OE i rekomanduar ka dorëzuar një listë prej 51 projekteve, të cilat nuk përfshihen në periudhën e fundit trevjeçare nga data e njoftimit për kontratë; referenca që nuk janë pjesë e listës së kontratave të nënshkruara nga OE; si dhe një pjesë e listës së kontratave për të cilat nuk janë bashkëngjitur referencat përkatëse.

AK gjatë rivlerësimit nuk e ka trajtuar fare listën e referencave, si dhe nuk i ka identifikuar dhe as arsyetuar kontratat dhe referencat të cilat i ka konsideruar se e përmbushin kërkesën sipas FDT-së, por në mënyrë të përgjithshme ka vlerësuar se ato i plotësojnë kërkesat, duke mos vepruar në përputhje me Interpretimin e KRPP-së të datës 09.06.2023.

Si përfundim, Eksperti shqyrtues vlerëson se AK, gjatë rivlerësimit, nuk i ka adresuar rekomandimet dhe, rrjedhimisht, ka dështuar të veprojë në përputhje me Vendimin e PSH 2025/850, nenin 40 të RRPP-së dhe interpretimin e KRPP-së, andaj **pretendimi ankimor vlerësohet i bazuar**.

Për vëmendjen e PSH-së vlen të theksohet se AK, gjatë trajtimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nuk e ka trajtuar njëjtë me të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ku për LOT I e ka eliminuar OE Global Holding me arsyetimin se i njëjti duhet në vazhdimësi të ketë validitet, pa ndërprerje, dhe se nuk lejohet zgjatja në mënyrë retroaktive, ndërsa në këtë LOT II AK ka dërguar letër për sqarimin e tenderit (vazhdim validiteti) me datën 10.10.2025, me afat të dorëzimit të vazhdimet deri më datën 15.10.2025. OE i rekomanduar për kontratë nuk është përgjigjur deri më datën 16.10.2025, që është në kundërshtim me kërkesën e AK-së, por pavarësisht dështimit të OE të rekomanduar që t'u përmbahet afateve të AK-së, nuk është penalizuar.

Nga kjo rezulton se OE i rekomanduar për kontratë po ashtu nuk ka validitet të vazhdueshëm, me shpëputje nga data 13.10.2025 deri më datën 16.10.2025.

Dërguar nga : " EJONA " SH.P.K.

Dokumenti për dërgim te AK

[20251016093627451.pdf](#)

16.10.2025 09:08

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

Dërguar nga : MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

B47 Letër Standarde e kërkeses për sqarimin e tenderit

[B47 - Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit EJONA.docx](#)

10.10.2025 16:47

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës per LOT II dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **AVAG GROUP SH.P.K.**

Burim Zeka

